



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500312/2

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në I.E.V.Penale Vaqarr.*

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur Zoto

TIRANË

Drejtorit të I.E.V.P Vaqarr
Z. Bardhyl Faskaj

VAQARR

Të nderuar Zotërinj,

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës¹, kreu një inspektim të përgjithshëm në I.E.V.P Vaqarr, më datë 24.02.2015. Në përbërje të grupit inspektues bënë pjesë Z. Alfred Koçobashi (jurist), Alma Alibali (mjeke psikiatër), Iriša Laçi (juriste) N/Komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, të shoqëruar nga ekspertët e Shoqatës "Përthyerje", në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar Parandalues në kuadër të *OPCAT-it* me OJF të specializuara të fushës.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të dënuarve dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si vijon:

¹ Në mbështetje të nenit 19/1 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Shënime të përgjithshme

Vizita monitoruese e stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtoria e Institucionit ekspertëve iu mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm në Institucion, brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoroheshin. Gjatë takimit paraprak me Drejtorin e IEVP-së Z. Bardhyl Faskaj grupi monitorues u informua mbi situatën në institucion dhe problematikat e hasura nga ana e administratës në IEVP Vaqarr. Si rezultat i mbylljes së disa IEVP-ve në kuadrin e restaurimeve dhe reformave në sistemin e burgjeve së fundmi IEVP Vaqarr i është nënshtruar disa ndryshimeve duke kaluar nga burg i sigurisë së zakonshme në institucion paraburgimi. Sipas drejtorit transferimi dhe vendosja e të ardhurve kryesisht nga IEVP-të Mine Peza dhe Jordan Misja, Tiranë në këtë institucion ishte kryer normalisht dhe në mënyrë të qetë. Por nga ana tjetër transferimi i të dënuarve në IEVP- te tjera dhe akomodimi i të paraburgosurve të ardhur rishtas në këtë institucion ka qënë një ngarkesë pune e zgjatur dhe e lodhshme për stafin pasi ndryshimi i regjimit nga burg në paraburgim ka paraqitur problematikat e veta. Gjithsesi sipas drejtorit transferimi është përballuar me sukses dhe të paraburgosurit janë akomoduar nëpër dhoma dhe stafi është munduar që ti sistemoj duke studiuar dosjet e tyre dhe përshtatje sipas rasteve.

Si pasojë e kësaj situate të re të krijuar në këtë IEVP, Drejtori evidentoi si problemet më kryesore mbipopullimin, elementët e sigurisë në ambientet e ajrimit dhe numrin e kufizuar në organikë të stafit të sigurisë veçanërisht i atyre në funksionin e rojeve vëzhguese të perimetrave të sigurisë. Ndërkohë problematika të tjera që kanë rrjedhur si pasojë e transferimit dhe vendosjes së paraburgosurve në këtë institucion kanë qënë transportimi dhe administrimi i veshjeve dhe orendive personale dhe dorëzimi i tyre pranë të dënuarve dhe paraburgosurve si dhe informimi i të gjithë familjarëve për vendndodhjen e re të pjesëtareve të tyre të familjes. Gjatë procesit të transferimit kishte pasur ankesa të shumta nga ana e të paraburgosurve lidhur me mundësinë për telefonata duke qënë se për çdo seksion ka vetëm një aparat telefoni e pamjaftueshme për numrin aktual të paraburgosurve në atë seksion si dhe ankesa për moslejimin e transferimit të mjeteve elektroshtëpiake si TV dhe frigorifer të cilat kufizohen nga Urdhri në fuqi i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 3895, datë 09.04.2013, i cili lejon në mjediset e banimit vetëm pajisjet që blihen nga institucioni me një komision të posaçëm.

Grupi monitorues u informua se kapaciteti zyrtar i IEVP-së është 146 persona ndërsa aktualisht në momentin e inspektimit ndodheshin 179 të paraburgosur dhe 1 person i dënuar. Në institucion nuk kishte të mitur por kishte 18 të paraburgosur të cilët i përkisnin kategorisë së 19-21 vjeçarëve të cilët jo të gjithë ishin të grupuar në një seksion të veçantë. Ndarja e regjimeve dhe vendosja e të paraburgosurve në dhoma ishte akoma në fazën e studimit të dosjeve dhe përshtatja sipas rasteve. Në IEVP Vaqarr kishte katër persona të cilët trajtoheshin me metadon, shtatë shtetas të huaj mes të cilëve pesë shtetas Kosovarë, një Italian dhe një Gjerman. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person me masë disiplinore. Gjithashtu grupi inspektues u informua nga ana e administratës së IEVP Vaqarr se në muajin e fundit kishte patur disa

ngjarje të rënda si një tentativë arratisjeje si dhe me datë 11/02/2015 një i paraburgosur i sapo ardhur në institucion kishte tentuar vetëvarjen por ishte ndaluar në kohë nga punonjësit e IEVP-së dhe menjëherë ishte marrë një plan masash për trajtimin e tij.

Organika e institucion ishte e plotësuar dhe nuk kishte mungesa në stafin civil apo në atë të sigurisë por me situatën e re të ndryshimit të funksionit të IEVP Vaqarr ishte kërkuar që të ketë shtesa në stafin e sigurisë prej të paktën 5 punonjësish të rolit të sigurisë. Gjithashtu në IEVP Vaqarr në momentin e inspektimit kishte 12 të paraburgosur të punësuar kryesisht në kuzhinë, pastrim, gjelbërim, shpërndarje ushqimi, bibliotekë dhe magazinë.

1. Trajtimi

Gjatë vizitës monitoruese grupi i ekspertëve vizitoi dhe kontaktoi me të paraburgosurit në të gjitha ambientet e IEVP Vaqarr. Në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre si ajrimi, takimi me familjarët, telefonatat, servirja e rregullt e ushqimit etj., të paraburgosurit u bënë me dije eksperteve se përgjithësisht u respektoheshin këto të drejta.

Gjithashtu gjatë bisedave konfidenciale dhe intervistave të bëra me të paraburgosurit nëpër dhoma rezultoi se nuk kishte raste të përdorimit të forcës fizike, ushtrimit të dhunës, presionit psikologjik apo raste torture. Transeferimi nga paraburgimet e tjera drejt Vaqarrit kishte qenë korrekt me përjashtim të disa problematikave si njoftimi i familjarëve i cili nuk ishte bërë në kohë si dhe ne disa raste pajisjet personale dhe veshjet kishin humbur gjatë transportit dhe nuk ishte bërë shpërndarja e tyre në mënyrën e duhur.

Në përgjithësi marrëdhëniet mes stafit të ri të regjimit të brendshëm dhe të paraburgosurve rezultoi të ishte korrekt dhe nuk u konstatuan ankesa nga ana e të paraburgosurve lidhur me raportin interpersonal ndërmjet të paraburgosurve dhe personelit të sigurisë. Ankesat kryesore lidheshin me shërbimin shëndetësor, dyqanin, çmimet e produkteve dhe transferimin e parave të paraburgosurve nga IEVP-të e mëparshme. Shumë prej të paraburgosurve nuk kishin marrë akoma transferimin e parave nga dyqanet e IEVP-të Mine Peza dhe Jordan Misja.

2. Masat mbrojtëse.

Në momentin e vizitës monitoruese IEVP Vaqarr rezultoi me mbipopullim, i cili, siç u pranua edhe nga vetë drejtuesit e këtij institucioni, në vazhdimësi gjatë gjithë vitit ka qenë i lartë.

Për efekt edhe të mbipopullimit, nuk kishte një ndarje në seksion të veçantë për grup-moshën 18-21 vjeç. Ata ishin vendosur në të njëjtin sektor me

të rriturit, por në dhoma të veçanta. Aktivitetet e përbashkëta 18-21 vjeçarët i kryenin së bashku me madhorët.

Ekspertët morën informacion në lidhje me pritjen e të paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe në lidhje me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me Drejtuesit e Institucionit dhe verifikimeve në dosje grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, çdo gjë regjistrohet në regjistrin përkatës dhe protokollohet. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit.

Takimet me familjarët në I EVP Vaqarr zhvilloheshin rregullisht. Në ambientet e takimeve, gjendeshin disa sportele të ndara me hekura dhe në dy anët e sporteleve. Familjarët zhvillonin biseda me të paraburgosurit pa pasur mundësinë e kontaktit fizik që do të mund të krijonte takimi rreth një tavoline në kushte të tjera. Nga vëzhgimet e grupit inspektues, rezultoi se nuk kishte një mjedis të veçantë për takimet me personat e moshuar, apo me të miturit, të cilët nuk duhet të takonin të afërmit e tyre të dënuar/ paraburgosur përmes hekurave, por mundësisht në një mjedis më miqësor për këto kategori.

Institucioni kishte në funksion sistemin e monitorimit me kamera dhe në regjim u konstatuan se kishte kamera vëzhgimi të cilat mbulonin kryesisht pjesët e korridoreve dalës deri tek pjesa e kolonës. Vëzhgimi kryhej për 24 orë. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve çdo gjë regjistrohet në regjistrin përkatës dhe protokollohet. Duhet të përshtateshin regjistrat me terminologjinë e paraburgimit dhe të shtohet regjistri i ngjarjeve të rënda.

Sistemi i ankesë / kërkesave funksiononte dhe ekzistonin të gjitha format e gatshme të kërkesë ankesave të cilat mbaheshin nga stafi i edukimit. Për një procedurë ankesë/kërkesë të paraburgosurit në këtë I EVP, plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose jo. Ky i fundit i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, grupi i inspektimit konstatoi se pothuajse në të gjitha seksionet e regjimit mungonin kutitë e depozitimit të ankesave/kërkesave dhe çdo dokument përcillej dorazi. Në regjistrin e ankes/kërkesave ishte e përcaktuar me shkrim se nga cili anëtarë i stafit merrej ankesa dhe forma e zgjidhjes dhe trajtimit të saj.

Për raste dhe situata të veçanta pas ngjarjes së ndodhur më datën 11/02/2015, ku një i paraburgosur kishte tentuar të vetëdëmtohej nëpërmjet aktit të vetëvarjes, nga ana e Institucionit me iniciativë dhe me anë të miratimit të drejtorit ishte ngritur një grup pune i përbërë prej stafit të kujdesit shëndetësor, stafit të edukimit dhe atij policor dhe ishte hartuar një plan masash për identifikimin, parandalimin, mbrojtjen dhe trajtimin e këtyre rasteve. Ndërsa person ishte mbajtur nën monitorim të vazhdueshëm në mënyrë që të realizohej rehabilitimi i plotë deri në momentin që të mos përbënte më rrezik për veten.

3 . Kushtet materiale

IEVP Vaqarr i kthyer ne një Institucion paraburgimi ka një infrastrukturë prej dy katesh të ndarë në dy seksione. Në seksionin 1-rë i cili ndodhet në katin e parë gjenden 14 dhoma në të cilat janë të vendosur nga 4 deri në 10 të paraburgosur, gjithsej 64 ndërsa në seksion II-të kati 2 i ndarë në dy sektorë akomodohen rreth 100 të paraburgosur me një shpërndarje 6 deri në 8 persona për dhomë. Të gjitha dhomat kanë tualete dhe dushe brenda. Baza materiale në dhoma është e plotësuar dhe të gjithë të paraburgosurit kanë shtretër, tavolina, dollap, stola etj. Batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë por ishin sjellë nga familjarët e të paraburgosurve.

Ndër problematikat kryesore që paraqiste infrastrukturës të vëzhguara gjatë inspektimit ishin: problemet e lagështirës e cila shfaqet shumë shqetësuese në katin e parë të godinës ku pothuajse i gjithë muri i jashtëm ishte tejet i amortizuar. Lagështira ishte prezente edhe në katin e dytë dhe kryesisht në pjesën e mureve ngjitur me tualetet.

Gjithashtu problematike shfaqeshin kanalizimet e ujërave të zeza ku mjaft e dukshme kjo problematikë shfaqej në pjesën e oborrit drejt kuzhinës ku ujërat e zeza ishin të dukshëm në sipërfaqe dhe mund të ktheheshin në burim epidemie .Problematikë tjetër shfaqet dhe tek rrjetat e ambienteve të ajrimit të cilat ishin të dëmtuara në disa pjesë të tyre.

Dhomat e veçimit dhe izolimit ishin në katin e parë të godinës. Për të plotësuar funksionet e observimit dhe izolimit shërben një godinë e përbëre nga gjashtë dhoma. Të gjitha dhomat akomodonin dy persona. Aktualisht duke qenë se nuk kishte asnjë person me masa disiplinore në këto ambiente ndodhen vetëm tre persona në observim. Njëri prej të cilëve ishte i dënuar dhe priste lirim dhe dy të tjerët të paraburgosur, që të tre personat ndodhen me dëshirën e tyre në këto ambiente. Ata qëndronin në ambientet e observimit nga 15 ditë deri në dy muaj. Dhomat nuk kishin as tualete dhe as dushe brenda, ato ishin të përbashkëta, gjithsej një tualet dhe një dush për të gjithë sektorin e observim/veçimit. Në ambientet e dusheve kishte ujë të ngrohtë dhe këto ambiente ishin me pajisje hidrosanitare të plotësuara. Këto ambiente kishin lagështirë por ajo ishte në nivele të ulëta krahasuar me lagështirën në ambientet e paraburgimit.

Nga vëzhgimi i dhomave të banimit mund të themi se dhomat janë të pajisura me orënditë e nevojshme, dritaret janë të bollshme çka ndihmon në futjen e dritës natyrale. Problem ngelet prezenca e lagështirës e cila ishte shumë e evidentueshme dhe kryesisht me problematike shfaqet në katin e parë. Pothuajse faqet e murit ngjitur me tualete kishin një lagështirë tej normës së lejuar çka përbënë problem dhe sjell pasoja të rënda në shëndetin e personave që jetojnë aty. Nuk kishte persona që flenë në tokë me dyshek, dhomat deri diku ishin me hapësirë të mirë por kubatura e tyre nuk është e mjaftueshme për të përmbushur standardin e 3 m³ hapësire jetike për person. Në dhoma kishte 6-8 persona çka në shumicën e rasteve sillte probleme në kryerjen e dusheve pasi këtë të fundit e kushtëzonte dhe orari i ujit të rrjetit i cili nuk ishte i mjaftueshëm. Shumë nga të paraburgosurit kishin ngelur dhe pa rroba dhe sende personale pasi gjatë transferimit një pjesë e konsiderueshme

e tyre kanë humbur dhe ka qenë e vështirë për ti identifikuar. Ata u ankuan se asnjë masë nuk ishte marrë nga stafi për rregullimin e këtij problemi.

Higjiena në korridore dhe në dhomat e të paraburgosurve është e mirë. Problem shqetësues dhe mjaft i dukshëm është lagështira e cila është në nivele shumë të larta. Gjithashtu institucioni ka zgjidhur problemin e furnizimit me ujë me anë të rrjetit duke shmangur ujin e pusit por problem qëndron në faktin se uji është me orare tre herë në ditë dhe këto orare janë shumë shkurtra. Gjatë intervistave pati ankesa se orari i ujit të rrjetit i kushtëzon në kryerjen e dusheve, larjen e ndërresave dhe enëve të ushqimit, sidomos për ato dhoma ku ka 6-8 persona. Problem tjetër është fakti se në IEVP nuk ka lavanderi dhe të paraburgosurit i lajnë rrobat e tyre vetë ndërsa çarçafët dhe batanijet i dërgojnë tek familjarët. Ka problem me furnizimin me detergjente të higjienës personale dhe pjesa më e madhe e të paraburgosurve i marrin ato nga familjarët ose i blejnë në dyqanin e IEVP-së.

Nga vëzhgimi që grupi i ekspertëve monitorues zhvilloi në kuzhinën e institucionit të Vaqarrit arrijmë në konkluzionin se kuzhina është në gjendje të mirë dhe e pajisur me orëditë e nevojshme. Higjiena në kuzhinë është e kënaqshme. Në të punojnë disa të dënuar kryesisht në pastrim dhe shpërndarjen e ushqimit. Cilësia e ushqimit e gatuar në ditën e vizitës monitoruese dukej e mirë. Evidencat e gramaturave dhe menyja ditore ndodheshin në kuzhinë dhe ishin të afishuara. Kampionet e ushqimit të gatuar një ditë më parë ndodhen në kushte frigoriferike dhe të kyçura. Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit rezultoi se nuk kishte ankesa për ushqimin. Pothuajse pjesa më e madhe e të paraburgosurve e konsumonin ushqimin e gatuar në institucion dhe kjo ishte për tu përgëzuar.

4. Regjimi dhe aktivitetet

Aktivitetet kryesore që zhvilloheshin në këtë institucion ishin futbollit dhe ping-pongu. Në ambientet e katit të dytë në sektorin II gjendej dhe salla e aktiviteteve e cila kishte disa funksione. Ajo shërbente si sallë aktivitësh, kompjuterësh dhe takimesh të përbashkëta. Në të ndodheshin disa tavolina dhe një kompjuter i cili ishte funksional. Gjithashtu brenda këtij ambienti por në një dhomë më të vogël ndodhej dhe biblioteka ku kishte libra të cilët ishin kryesisht tituj të vjetër dhe ngelet për tu pasuruar më shumë. Gjithashtu ofrohej ndjekja e aktiviteteve të riteve fetare e cila ofrohej po në këtë ambient.

Për sa i përket ajrimit të gjithë të paraburgosurit u shprehën se ky institucion ofron ambiente më të përshtatshme për ajrimin pasi në IEVP-të Mine Peza dhe Jordan Misja hapësirat e ajrimit ishin shumë të vogla dhe të kushtëzuara. Ajrimi është një nga aktivitetet më të rëndësishme për ta dhe ofrohej 2 orë në ditë ku gjatë të cilit kryhej dhe kalçeto.

Ndër aktivitetet profesionale dhe integruese nga ana e stafit na u pohua se ishin në pritje të fillimit të kurseve profesionale si: anglisht, italisht dhe kursit të hidraulikës. Ishin krijuar grupet e para sipas preferencave dhe tashmë pritej fillimi i kurseve me një urdhër nga Drejtoria Arsimore dhe Zyra e Formimit Profesional, Tiranë. Kurset e para priteshin që të fillonin në muajin Mars 2015.

Në lidhje me aktivitete pati disa ankesa nga të paraburgosurit ku ata pohuan se janë të varfër dhe shumë prej tyre kanë marrë pjesë vetëm disa herë.

Nga bisedat konfidenciale me të paraburgosurit rezultoi se ka pakënaqësi në zhvillimin e takimeve me familjarët. Ankesat vinin kryesisht pas zhvendosjes së tyre në këtë institucion. Zakonisht sipas ankesave familjarët e të paraburgosurve futen shumë vonë në ambientet e takimeve dhe j'u duhet të presin shumë gjatë, para se takimi të zhvillohet. Sipas drejtuesve të institucionit kjo vonesë ka ardhur si shkak i numrit të kufizuar të stafit i cili nuk është i mjaftueshëm për të kryer procesin e kontrollit.

Ambienti në të cilin zhvillohen takimet është një dhomë e ndarë nga një zgarë hekuri në njërën anë të së cilës qëndrojnë familjarët, ndërsa në anën tjetër të paraburgosurit. Ky ambient është i papërshtatshëm për takime pasi nuk është i ndarë në bokse ku çdo i paraburgosur të komunikojë privatisht me familjarët. Gjithashtu gjatë takimit si të paraburgosurit edhe familjarët qëndrojnë në këmbë pasi mungojnë stolat

Takimet me fëmijët e vegjël dhe prindërit e moshuar zhvillohen në një ambient të veçantë të pajisur me karrige dhe tavolina, ndërsa dhoma e takimeve speciale është kthyer në dhomë për takimin me avokatin. Kjo dhomë është e pajisur gjithashtu me karrige dhe tavolinë.

Për sa i përket komunikimit me telefon ka ankesa në masë të konsiderueshme pothuajse nga të gjithë të paraburgosurit se ky proces nuk plotëson nevojat e tyre. Të paraburgosurit ankoheshin që koha e telefonatave që ata flisnin ishte shumë e vogël . Duke qenë se në çdo sektor kishte vetëm një kabinë telefoni rezultoi se kishte pengesa në kryerjen e këtij shërbimi. Rregullimi i një shtate të tillë kërkon që për çdo sektor të shtohet dhe nga një kabinë telefoni në mënyrë që komunikimi me telefon të zhvillohet normalisht.

Dosjet Psiko-Sociale ishin transferuar sipas të paraburgosurve dhe stafi i edukimit akoma ishte duke u njohur me pjesën më të madhe të tyre. Sipas stafit të edukimit shqyrtimi i parë i dosjeve ka qenë i përgjithshëm në mënyrë që të behej akomodimi dhe ndarja nëpër dhoma. Ndërsa njohja në detaje me dosjet kërkonte kohë pasi për këtë stafi i edukimit duhet të zhvillojë dhe takime individuale me çdo të paraburgosur. Në përgjithësi nuk kishte pasur probleme dhe procesi i transferimit kishte rrjedhur i qetë. Takimet me të paraburgosurit zhvilloheshin në sallën e këshillimit. Stafi i edukimi po punonte për krijimin e grupeve të cilat do të merrnin pjesë në kurset profesionale dhe aktivitete të tjera integruese. Ata gjithashtu kishin zhvilluar diskutime për tema të ndryshme që kishin ndihmuar të paraburgosurit ne procesin e përshtatjes në këtë institucion të ri duke ju ofruar aktivitete të ndryshme në sallën e aktiviteteve si lojëra pingpongu, diskutime në grup, etj.

5. Shërbimet shëndetësore

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhej nga një mjek, me kohë të plotë, 1 stomatolog, 1 farmacistë dhe 4 ndihmës mjekë.

Gjatë vizitës sonë në këtë IEVP, si dhe nga intervistat me të dënuarit problematikat më të shumta që u konstatuan, për sa i përket shërbimit shëndetësor, kryesisht të lidhura me ilaçet, të cilat në shumicën e rasteve mbulohehin nga familja, pasi vetë institucioni kishte mangësi të theksuara të tyre. Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai ofronte mjekime të urgjencës dhe ekstraksione. Ndërkohë që nga të dënuarit morëm një vlerësim pozitiv për mjekun e këtij institucioni, e cili kryente vizita të rregullta në regjim, iu përgjigjej në kohë dhe në çdo rast kërkesave të të /paraburgosurve, dhe sa herë nevojitej realizonte konsulta të specializuara jashtë institucionit.

Sipas informacionit që u dha nga përgjegjësi i sektorit shëndetësorë në këtë institucion në ditën e vizitës inspektuese nuk kishte një statistikë mujore të personave që trajtoheshin me sëmundje kronike, përveç 4 personave abuzues me substanca narkotike, të cilët trajtoheshin me Metadon. Kjo për shkak të transferimeve të ditëve të fundit që janë bërë në këtë Institucion. Personat që vuanin dënimin aktualisht në këtë IEVP ishin të gjithë të ardhur nga Institucione të tjera.

Gjithashtu, gjatë bisedave me stafin drejtues u konstatua se në këtë institucion më datë 12.02.2014, shtetasi J.H ka tentuar vetëvrasjen me çarçaf. Në momentin e kryerjes së aktit ka ndërhyrë stafi i sigurisë dhe më pas stafi i sektorit shëndetësor ka bërë vlerësimin në vend. Sipas këtij vlerësimi parametrat vital jetësor të këtij shtetasi ishin të mira, ndërsa statusi mendor i tij është vlerësuar me ngarkesë të theksuar emocionale. Nga të dhënat e administruar nga kartela mjekësore personale dhe anamneza e përshkruar aty rezultoi se ky shtetas ka qenë përdorues droge të tipit heroinë, gjithashtu gjatë qëndrimit në këtë institucion ka manifestuar disa simptoma somatike dhe çrregullime të gjumit. Mjekimi që i ishte rekomanduar shtetasit J.H ishte i përbërë nga Metadoni dhe Lorami. Pas tentativës vetëvrasëse, mjeku i institucionit kishte kërkuar konsultë psikiatri si dhe konsultë dermatologu për disa formacione makulo-papuloze, purolente në lëkurë. Nga konsulta e bërë me psikiatren e IVSHB-së ky shtetas ka rezultuar pa probleme psikiatrike, por është përcjellë për konsultë tek toksikologu. Në ditën e vizitës inspektuese u konstatua se gjendja psiko-emocionale e këtij shtetasi ishte e mirë dhe e stabilizuar.

Institucioni kishte një autoambulancë, e cila ishte siguruar kohët e fundit.

Dhoma e vizitave të mjekut ishte rregullt e pastër e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, ndërsa në godinën e administratës dhoma e mjekut kishte një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës dhe një tjetër ku mbaheshin kartelat mjekësore të kyçura me dry.

Dhoma e stomatologut gjithashtu ishte e rregullt, e pajisur me unit, autoklavë dhe instrumente dentare në kushte të amortizuara, por funksionale, ndërkohë që materialet dentare, stomatologu i këtij institucioni i siguronte privatisht.

Farmacia e këtij institucioni ishte e rregullt dhe e pajisur pjesërisht me ilaçe për sëmundjet kronike dhe ato për sëmundjet akute, pas një furnizimi të bërë së fundmi nga DPB, por jo nga sipas skemës së rimbursimit të ilaçeve.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave të mjekut, regjistri themeltar i të paraburgosurve dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, ndërsa mungonte regjistri i evidentimit të rasteve të rënda.

Me libreza shëndetësore ishin të kompletuar vetëm 4 të paraburgosur, ndërsa shtetasit e tjerë të paraburgosurit nuk ishin të pajisur me libreza për shkak të lëvizjeve që ishin bërë kohët e fundit të lart përmendur. Ndërkohë që skema e rimbursimit të ilaçeve nuk ishte funksionale, por kjo skemë s'kishte gjetur zbatueshmëri për shkak të mungesës së pajisjes së të gjithë shtetasve të cilët vuanin dënimin në këtë institucion me dokumentacioni përkatës e për rrjedhojë të librezave shëndetësore.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të ligjit Nr. 9888 datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ku parashikohet midis të tjerash se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruës”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrja e masave të menjëhershme për shtimin në organik të një stafi prej 5 punonjës të rolit të sigurisë në përshtatje të rolit të ri të institucionit IEVP Vaqarr si institucion paraburgimi;
2. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin dhe rritjen e elementëve të sigurisë në ambientet rrethuese dhe në ambientet e ajrimit ku rrjetat ndarëse janë të dëmtuara;

3. Marrja e masave të menjëhershme për kryerjen e termo-izolimit të të gjithë godinës në mënyrë që të shmanget lagështira e cila në momentin e inspektimit ishte tej normave të lejuara;
4. Marrja e masave të menjëhershme për të shtuar nga një kabinë telefoni për çdo sektorë në mënyrë që komunikimi i të paraburgosurve me familjarët të zhvillohet normalisht;
5. Marrja e masave të menjëhershme për mundësimin e pajisjes së paraburgosurve me pajisjet elektroshtëpiake të cilat ato kanë patur në Institucionet nga vijnë para transferimit në IEVP Vaqarr.
6. Marrja e masave të menjëhershme për përshtatjen e regjistrave më terminologjinë e institucionit të paraburgimit dhe shtimi i regjistrit të ngjarjeve të rënda;
7. Marrja e masave të menjëhershme për rregullimin e menaxhimit të procesit të kërkesë/ankesave dhe vënien në funksion të kutive postare në seksione.
8. Marrja e masave të menjëhershme për shmangien e vonesave dhe pritjes së gjatë të familjarëve para takimeve me të paraburgosurit;
9. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të dhomave të banimit në sektor dhe shmangies së lagështirës;
10. Marrja e masave për rregullimin e kanalizimeve të ujërave të zeza;
11. Marrja e masave të menjëhershme për gjetjen e teshave dhe sendeve personale të cilat kanë humbur gjatë procesit të transferimit të paraburgosurve në IEVP Vaqarr;
12. Marrja e masave të menjëhershme për krijimin e mundësive për ofrimin e shërbimit të lavanderisë për larjen e ndërresave personale;
13. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e të gjithë paraburgosurve me librezë shëndetësore dhe vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
14. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomës së stomatologut me materiale dentare, në mënyrë që të ofrohet një shërbim efikas stomatologjik nga ana e këtij institucioni.
15. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen sektorit shëndetësor me një regjistër të evidentimit të rasteve të dhunës.

16. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e formateve të kontrollit mjekësor, të cilët bëjnë të mundur dokumentimin dhe evidentimin e rasteve të dhunës së ushtruar në komisariate, ndaj shtetasve të cilët sillen për vuajtjen e dënimit në këtë IEVP, si dhe për të evituar ekuivokët në lidhje me raste të tilla.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë dhe me porosi

KOMISIONER

Ermir KAPEDANI